




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCija PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	DPK
Bip.	
Dep.	
Nr. faks.	
Broj stranica	02
Nr. pages	
Nr. Prot.	03-02/3289/hz
B: Prot.	
Prot. No.	
Data:	16.10.2012
Datum:	
Dati:	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY



Në mbështetje të nenit 11 (paragafi 1.1), nenit 5 (paragafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 13.10.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbylljet rasti me Nr. AKK-03-02-2516-17, për Zyrtarin e lartë z.Betim Kollari–Drejtor i Drejtorisë së Inspepcionit në komunën e Vushtrrisë, për shkak se ështëshmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, me Nr. AKK-03-02-2516/17, për Zyrtarin e lartë, z.Betim Kollari – Drejtor i Drejtorisë së Inspepcionit në komunën e Vushtrrisë, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznes privat, është trajtuar sipas procedurave të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Fillimisht, Agjencia kundër Korrupsion i ka bërë shkresë njoftuese zyrtarit të lartë z.Kollari (DPK-03-02-2713-17), dhe pastaj ai ka ardhë në Agjencinë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Kollari është deklaruar se nuk ka pasur njohuri për këtë situatë dhe shumë shpejt do të bëjë ndryshimet e nevojshme për të shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë, ai në Agjencinë kundër Korrupsionit, me një letër përcjellëse, ka dërguar informatën zyrtare nga Agjacioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) me njoftimin për shuarjen vullnetare të biznesit N.H.P.”B&B” (DPK/Dpki-03-02/3203/17), me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit


/ Shaip Havalli /

